

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE GARANCISE

1. Definicione te sigurimit te garancise

- Garantuesi: Shoqeria e Sigurimeve “ATLANTIK” sha
- Perfituesi: Enti Prokurues
- Kontraktuesi: Subjekti per te cilin leshohet Çertifikata e Garancise

Vlefshmeria e Çertifikates se garancise

- a. Çertifikata e garancise eshte e vlefshme vetem kur eshte e shoqeruar me Kushtet e Pergjithshme te Sigurimit te Garancise mbi bazen e te ciles ajo eshte leshuar, ne te kundert Çertifikata e Garancise eshte e pavlefshme.
- b. Ne rast se Perfituesi nuk e kundershton Çertifikaten perkatese te Garancise brenda 15 diteve nga data e nenshkrimit te kontrates midis tij dhe Kontraktuesit, atehere kjo Çertifikata e Garancise e leshuar ne baze te saj do te konsiderohet e pranuar prej Perfituesit dhe nuk mund te kundershtohen me.
- c. *Efekti veprues i kesaj garancie, qe do te thote fillimi i detyrimit te Garantuesit sipas kesaj çertifikate, fillon mbas perfundimit te afatit te fundit te percaktuar ne marreveshjet dhe/ose kontratat e lidhura midis Kontraktuesit dhe Perfituesit qe sjellin detyrimet kontraktuale per Kontraktuesin, qe do te thote se Perfituesi nuk mund te paraqese kerkesa ne zbatim te kesaj kontrate, kur Kontraktuesi eshte brenda afatit per permbushjen e detyrimeve te tij ndaj Perfituesit sipas dispozitave ne fuqi*
- b. Nga momenti qe Garantuesi paguan ne favor te Perfituesit shumen e Garantuar, Kontraktuesi pranon detyrimin per te demshperblyer Garantuesin per shumen e paguar, brenda 10 diteve nga njoftimi i bere Kontraktuesit nga Garantuesi.

Ne rast se Kontraktuesi brenda afatit 10 ditor nuk paguan shumen e Garantuar, Kontraktuesi pranon detyrimin per te paguar per çdo dite vonese, kamaten ne masen 1 % te shumes se Garantuar.

- c. Ne rast mosmarreveshje, Garantuesi e zgjidh pretendimin me padi regresi para Gjykates se Shkalles se pare, ne qytetin ku eshte leshuar Çertifikata e Garancise.